

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Debati te Ligjet/ Ulsi Manja nuk lejon të flasë kreun e Unionit të Gjyqtarëve: Fikini mikrofonin
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/debati-te-ligjet-ulsi-manja-nuk-lejon-te-flase-kreun-e-un-ionit-te-gjyqtareve-fikini-mikrofonin/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:54:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:34:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	28b902bfec5cefd22180c1cd54def60411839f2d9ebcf13828f583a635761767
TEKSTI	79966e59677dbbcd13093f4ab3a1c3a0eb13fdc42685cfb67b206feef1b1a799
PAMJA	3546520f30f4e3a5b02ac1905c89ca3ec314c9b0007a43509c20f8203fce8fca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2449b8f48d3946074aa2864c6eae0d16fe59dfacffe3a126a96731fd4293425d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2449b8f48d3946074aa2864c6eae0d16fe59dfacffe3a126a96731fd4293425d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Debati te Ligjet/ Ulsi Manja nuk lejon të flasë kreun e Unionit të Gjyqtarëve: Fikini mikrofonin

16:34:15/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Një debat i tensionuar është zhvilluar sot në Komisionin e Ligjeve mes kryetarit të tij, **Ulsi Manja**, dhe kreut të Unionit të Gjyqtarëve të, **Gerd Hoxha**.

Përplasja nisi pasi Hoxha kërkoi të shprehte qëndrimin e Unionit edhe për vendimin e Gjykatës Kushtetuese, mbi pagat e gjyqtarëve, ndërsa Manja e orientoi të fokusohet te projektligji që po shqyrtohej.

Debati u përshkallëzua me replika, deri në momentin kur **Manja urdhëroi fikjen e mikrofonit të Hoxhës**, duke i thënë: “Ky është Kuvendi i Shqipërisë dhe është sovran”.

Pjesë nga debati:

Manja: Zoti Hoxha e ka fjalën, për të dhënë edhe ai, në emër të Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, qëndrimin në lidhje me, të bëjmë një saktësim, me projektligjin, jo me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, vendimi i saj e ka thënë çfarë ka për të thënë vetë, ne duam një qëndrim tuajin me projektligjin që diskutuam sot.

Lexo edhe:

[‘Dreka’ ndërpret mbledhjen e Ramës në Pogradec, Manja ‘kapet’ me pjatë në dorë](#)

[Lura në flakë, Manja ndez “zjarrin” me Prokurorinë: Nëse zvarriteni, do t’ju verifikojnë](#)

Hoxha: Tani nëse na keni thirrur këtu, do na respektoni dhe do ta dëgjoni çfarë do të themi.

Manja: Jo jo, ju thoni çfarë të doni...

Hoxha: Në qoftë se do të më orientosh se si do diskutoj, më vjen keq, por nuk është kjo. Ne iu respektuam të gjithëve ju, ftesa erdhi 15 minuta përpara, nuk ishte aspak serioze, por për të respektuar Kuvendin, popullin shqiptar, magjistratët dhe Kushtetuesen, ne erdhëm sot këtu për të dhënë mendimet tona. Se çfarë do të diskutojmë ne, brenda kuadrit ligjor, atë e dimë ne, kështu që do t’iu lutesha të na dëgjoni. Do flasim për vendimin e Kushtetuese, ku është zanafilla. Nuk mund të shkojmë të flasim për degët, kur kemi prerë pemën. Nëse e pret

TË GJITHA



"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ Si u hapën dyert për Kushnerin

16:49 - 15/09/2026



Aksidenti i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës

16:47 - 15/09/2026



SHBA shpaloj strategjinë për Ballkanin, zyrtari i lartë i DASH: Kosova dhe Serbia të shmangin provokimet

16:38 - 15/09/2026



Debati te Ligjet/ Ulsi Manja nuk lejon të flasë kreun e Unionit të Gjyqtarëve: Fikini mikrofonin

16:34 - 15/09/2026



Gjykata e Brazilit miraton ekstradimin e Ervin Matës

16:32 - 15/09/2026



Zjarr në Gjirokastrë, flakët rrezikojnë banesat dhe një fabrikë uji

16:26 - 15/09/2026



I akuzuar për vrasje të mbetur në tentativë, Gjykata e Tiranës vendos ekstradimin e turkut në Zvicër

16:12 - 15/09/2026

pemën, degët bien në tokë, kështu që, ju lutem, na lini të flasim.

Manja: Zoti Hoxha, t'i ndajmë gjërat, ky është Kuvendi i Shqipërisë dhe është sovrani.

Hoxha: Po patjetër!

Manja: Ne kemi shumë respekt për pushtetin që ju përfaqësoni.

Hoxha: Na respektoni se na keni ftuar si miq.


Manja: Të lutem, të lutem, fiken mikrofonin, nuk regjistron. Ne kemi shumë respekt për ju. Edhe nuk ua kufizojmë të drejtat, shumë faleminderit që keni ardhur, do iu dëgjojmë me shumë vëmendje, fol çfarë të duash, shpreh opinionin në emër të Unionit të Gjyqtarëve, por jo me këtë gjuhë me sovranin, të lutem.

Hoxha: Gjuha ishte me shumë edukatë, në të njëjtin intonacion si ju...

Manja: Shiko, ju nuk mund të interpretoni fjalët e mija, unë kam gjatë durimin sot, edhe si kryetar komisioni, por edhe kolegët e mijë deputet, t'iu dëgjojmë deri në fund. Ju jepni opinionin tuaj se unë nuk orientoj çfarë do të thoni. Unë sot ju kam thirrur për projektligjin, për këtë ishte ndërhyrja ime, ju mund të thoni çfarë të doni, kështu që merrni fjalën, keni të gjithë kohën në dispozicion.

Etiketa: Gerd Hoxha Komisioni i ligjeve Ulsi Manja

Lajme të lidhura



'Dreka' ndërpret mbledhjen e Ramës në Pogradec, Manja 'kapet' me pjatë në dorë

16:31 : 23/08/2026




Lura në flakë, Manja ndez "zjarrin" me Prokurorinë: Nëse zvarriteni, do t'ju verifikojnë

22:46 : 14/08/2026



Luftë klanesh në PS/ Rama i ul kokën Çuçit, KPP nën kontrollin e njeriut të Ulsi Manjës

18:26 : 23/07/2026



"Po ne pse s'na dha biletë partia"/ Korreshi ironizon koncertin e Kanye West: Me 2 mln lekë këndonte gjithë Myzeqeja

13:44 : 21/07/2026



"E gjete lepurin në ferrë?", Gjyknuri përplasat me Manjën dhe braktis Komisionin e Ligjeve

11:26 : 14/07/2026



"Kanye West në SPAK"/ Bardhi-Manjës: Bën rolin e budallait për llogari të Ramës!

15:48 : 13/07/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

